



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË IX TË RREGULLT TË KUVENDIT KOMUNAL TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 28.09.2016 (E Mërkurë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu, këshilltarët e Kuvendit, Sami Demelezi, Zekrija Zuka, Nexhat Aliu, Xhilsime Qamili, Ali Bajrami, Adnan Imeri, Arbresha Ibrahim, Vjollca Kadolli - Halili, Nuredin Lutfiu, Ajtene Frangu, Bekim Azizi, Samet Idrizi, Taib Alidema, Hyse Rama, Visar Demiri, Bislim Bislimaj, Sejdi Emini, Baki Nebiu, Daut Xhemajli, Vjollca Sylejmani, Ekrem Abazi, Mirlinda Sadiku, Majlinda Ostrogllava, Selvije Rexhepi, Besjana Rexhepi. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, KFOR-i amerikan, përfaqësuesja e Zyrës Ligjore, përfaqësuesi i Zyrës për Integritet Evropian, mjetet e shkruara dhe elektronike, ndërsa në mbledhje mungoi Vehbi Rama.

Pasi u konstatua se prezent janë 26 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Përshëndetje për Nënkryetarin e Komunës z.Hasan Aliu, juve të respektuar Këshilltar komunal, Drejtorë të drejtorive, Përfaqësuesit e OSBE-së, në veçanti një përshëndetje e veçantë për KFOR-in amerikan, i cili është sot në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal dhe të gjithë të tjerët që janë sot prezent, dhe mirë se keni ardhur në mbledhjen e IX të rregullt të KK-së. Meqenëse sot ka koinsitu një datë, të them kështu e veçant, 28 Shtatori, mbajtja e seancës së rregullt dhe rënia heroike e dy dëshmorëve të kombit, Gursel e Bajram Sylejmani, unë ju kisha ftu të gjithëve, që me një minutë heshtje t’i nderojmë ata. Më lejoni të ju informoj, se Zyra Ligjore e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, na ka konfirmu ligjshmërinë e akteve, të cilët i kemi nxjerr ne si Kuvend Komunal. Më lejoni të ju falënderoj për kontributin e dhënë, dhe natyrisht duhet të falënderojmë edhe ekzekutivin, në krye me kryetarin e komunës,

të cilët kanë qenë të kujdesshëm, që aktet të cilët naj kanë sjell, kanë pas ligjshmëri të plotë dhe me që jemi të falënderimet, unë do të doja t'i uroja Majlindës, përfundimin e masterit, i urojmë fat dhe suksese në të ardhmen. Gjithashtu ju njoftoj, se kryetari i komunës është mungesë në këtë seancë, për faktin që është në takim zyrtar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe natyrisht nga atje i përcjell përshëndetjet për punët e Kuvendit komunal, që do të mbahen në këtë seancë të rregullt.

Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës, nëse ka dikush të parashtrij pyetje ose propozime, fjala është për ju, urdhëroni.

z.Bekim Azizi: Faleminderit kryesues, përshëndetje për anëtarë e Kuvendit, nënkryetar, drejtor të drejtorive, përfaqësues të KFOR-it dhe ju të tjerë që jeni prezent. Duke e pasur parasysh dje, që nëpërmjet mediave kemi pas një lajm, zotëri Kryesues, që ti je i dënuar për keqpërdorim të votave të qytetarëve, të vullnetit të qytetarëve, ne si grup i PDK-së, mendoje, që asnjë kuptim nuk është që ti të jesh me kryesues i Kuvendit, sepse nëse keqpërdoret vota e qytetarëve, sipas vendimit të gjykatës po thamë, të cilin e kemi pa në media, ti është dashur sot, fjalën e parë me dhënë dorëheqje prej kryesuesit, pasi që dënimi është gjashtë muaj me kusht, në media e kemi lexu dje, dhe mendojmë si grup, që ti duhesh me dhënë dorëheqje.

Kam një pyetje për drejtorin e Financave, ma herët i kemi pas 27 mijë e 500 euro mjete ndam nga Qeveria, për pagimin e dëmeve nga vërshimet në fshatin Budrikë e Gjylekar. Ato mjete na i kemi marr në Kuvend edhe i keni bartë për investime kapitale. Ato mjete a janë kthy a janë pranu?, se një shkresë që e kam pa të ministrisë, është që janë refuzu, që nuk kanë pas të drejtë ato të kthehen: Ku është puna, ku qëndrojnë ato mjete apo ato mjete janë tërheq nga Ministria që ma nuk i kemi?

z.Sami Demelezi: Fillimisht përshëndetje për nënkryetarin, kryesuesin, drejtorët, kolegët e ju të pranishëm. Edhe unë një pyetje për Bekimin: A ki pas moral Bekim deri sot me e ngrit çështjen, p.sh.: të një kryetari të komunave të Kosovës, që është ne burg ende pa e fillu mandatin, dhe paguhet si kryetar komune. Qysh pate moral dhe të drejtë, pa u skuqur hiq, që lype këtë prej kryesuesit dhe këto procese që kanë ndodh në Kosovën tonë?, dhe kurrë nuk kam ni, që ti e ki ngrit zërin për raste të tilla, e kur edhe ti, edhe unë e dimë, që këto janë procese politike.

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë nuk kame dashtë, që seanca të merr rrjedhën e këtillë, është e drejt e këshilltarëve komunal, që të kërkojnë edhe gjëra të tilla, unë do te jem i përgjegjshëm, do ta zbatoj me përpikëri ligjin, sepse konsideroj se të gjitha këto përpjekje të cilat janë bë, po thuaja në dy dekadat e fundit, kemi bë përpjekje me e kriju një rend dhe një ligj, dhe po ju betohem, se nëse ligji e thotë, se duhet kryesuesi apo kushdo qofte për këtë çështje të jep dorëheqje, unë me kënaqësinë më të madhe do ta bëj një gjë të tillë, sepse jam i përgjegjshëm para qytetarëve, jam i përgjegjshëm para elektoratit, jam i përgjegjshëm, sepse kam marr 550 vota, dhe aktakuza e cila mu ka ngritë mu, nuk ka të bëjë absolutisht me mandatin, të cilin unë e kam këtu, por është ngrit me një periudhë kur janë bë manipulimet më të mëdha, dhe jam i përgjegjshëm dhe e di që ka

qenë edhe atëherë e motivuam kjo, dhe tash pikërisht jam i bindur se nga kush paska qenë me tepër e motivuar. Ju faleminderit!

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Përshëndetje i nderuar Kryesues, Këshilltar të Kuvendit Komunal, Drejtor të drejtorive përkatëse, OSBE, KFOR-i amerikan, e ju të pranishëm. Megjithatë unë nuk jam ithtari i marrjes se kaheve të ndryshëm të Kuvendit, po jam ithtari i asaj që të përqendromi ne piken e rendit të ditës, por nuk jam ithtari edhe i asaj, të cilën e dinë mire çdo këshilltar i Kuvendit Komunal, kur duhet të jep një person zyrtar, në këtë rast një person i zgjedhur, dorëheqje, e dini fort mirë, e ne rast që nuk e keni ditë është mëkat i madh që nuk e keni ditë, se Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale e thotë shumë decitivisht kur, dhe prandaj unë konsideroj se e kemi një kryesues shumë të përgjegjshëm, që nuk duhet të shtrohet ato dilema. Gjithçka në Kosovën e pasluftës duhet të respektohet. Ligji shumë herë nuk të konvenon, nuk më konvenon edhe mu, por megjithatë nëse ato ligje janë të aplikueshme dhe i ka pru Parlamenti i Republikës së Kosovës, ato do të jenë edhe të implementueshem edhe ne Komunë të Vitisë, këtë e kemi dëshmu që tri vite edhe vete konfirmimi i te gjitha akteve të cilët i ka pru ky Kuvend, do ta konfirmojnë edhe ato, nëse është ne aspekt personal të individit deri ne fund, prandaj unë konsideroj humbje kohe rrethe asaj çështje dhe ngritja e këtyre dilemave humbe kohe e energji dhe nuk i takon juve si këshilltar të Kuvendit Komunale. Ju e dini shumë mirë, që ende ky nuk e ka marr as vendimin, është e drejta e ankesës, të cilën duhet ta ushtron dhe dihet kur vendimi e merr formën e prerë dhe vete vendimi i cili është i marr nuk e obligon dhënien e dorëheqjes, prandaj duhet të largomi rreth atyre etiketimeve, rreth atyre fjalëve, pavarësisht kush do të jetë ai nuk e përdori këtë fjalor vetëm për kryesuesin, do ta kishe përdorë për cilin do këshilltar të Kuvendit komunal dhe e kam përdor në vazhdimësi, se ne jemi obligativ nga betimi të cilin ju e keni dhënë, ta respektojmë Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale. Prandaj, keni të bëni me një kryesues te mirë, ndërsa ne akseptin e zbatueshmerisë, te ligjshmërisë, do te jem shumë të përpiktë dhe do ta zbatojmë. Ju faleminderit!

z.Bekim Azizi: Të ju përgjigjem Samisë, që mu nuk me vjen marre sa herë që gjykata merrë një vendim, qatë vendim me kërkmu zbatu. Samisë duhet mi ardh marre, se nashti edhe Samia ka vjedh vota me ta, ndoshta edhe Samia i ka porosit me vjedh vota, se ki vjedhë vota, ki shkel vullnetin e qytetarëve, gjykata e ka thënë, unë nuk kam thënë, në vendim gjykata thotë, e ka pranu që ka manipululu me vota, me 861 vota, edhe unë vetëm e kërkova përshkak, se na si këshilltar mu kane ma të qet përderisa është një vendim. Unë nuk po them që ki vjedh apo nuk ki vjedh, po vetëm atë që e kemi pa një vendim të gjykatës, e unë kërkova ne emër te grupit, e unë për Viti zakonisht kam fol, ndërsa për sene tjera fol ti Sami, se ti ki drejt me fol edhe për Skenderaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë edhe njëherë po e përsëris, do te jem shume i përgjegjshëm, nëse Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale, me të cilin është duke punuar ky Kuvend, jep një gjë të tillë, do të shkoj te shpija, se nuk e kam shumë dert Bekim, jam rritë, jam eduku me i respektu Ligjet e

shtetit të cilin e kemi kriju, jam rrit jam eduku me punu dhe jetu me njerësin time, ndërsa ata të cilët janë pasuruar në format të ndryshme dhe mendojnë ashtu si ti, turp ju qoftë.

z.Samet Idrizi: I nderuari Kryesues, përshëndetje për nënkryetarin, OSBE-në, KFOR-in amerikane, drejtoret e drejtorive, koleg e ju të pranishëm! Mue me befasoj shume reagimi i Samiut, kemi ni në media përditë, kërkojnë dorëheqjen e kryeministrit, ministrave. Kërkimi i dorëheqjes në këtë formë është shume demokratik. Nuk ka nevojë mu shqetësu këtu, po me vjen çudi, më pak po shqetësohet kryesuesi se Samiu, asamblisti nuk ka nevojë. Unë besojë që kryesuesi është i denjë me mbrojt vetveten. Pas gjithë kësaj, unë mendoj që kur e hapi mbledhjen këtu, sot kryesuesi pasi që na përshëndeti, u duftë me e qel këtë temë, ngase që ajo dje ka qen në media, dhe vete mos me lan hapësirë që me i tregu, se çka ka ndodh, nëse vërtet ajo çka gjykata ka qenë e skenume, dokumenti që gjykata e ka marr një vendime. Unë mendoj, qe kryesuesi duhet me reflektu, mënyra se si reflekton ai edhe tash mundësia e interpretimi te dytë. Në momentin që ngritët një aktakuzë ne vendet me demokraci të zhvilluara, ose në rastin kur gjykata me një formë e jep një dënim, në qoftë me kusht apo me burg efektiv, çdo zyrtar i lart, sidomos zyrtarët që punojnë ne kompani publike, ministri, komunë, duhet të veprojnë. Unë them prapë këtu, se kryesuesi i Kuvendit duhet te reflekton për këtë që ka ndodhe dje.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje Kryesues, Nënkryetar, Asamblist të nderuar, Drejtor, KFOR-I amerikan e ju te pranishëm! Unë këtu po e kuptoj këtë që paska ndodhë, e ku këtë punë e murrem me shume hezitim, që për mua nuk ka nevoje, mos të hymë ne si Kuvend të involvohemi ne punën e gjykatës. Kryesuesi e tha, as vendimin nuk e ka marr akoma, në moment që e merr na jemi qetu, nuk e kemi njet me ik prej Vitisë, analizohet, janë organet e drejtësisë që merren me këto punë po me duket e pa nevojshme që ne tashti te hymë krejt ne këtë polemikë pa nevoje, para se te hymë ne rend të ditës. Çka do që merr vendim gjykata, kryesuesi ke shume i kjart, atë do ta zbatoj, prandaj unë kisha kërku, që të procedojmë për ata se për çka jemi e për këto çështje ka kohë.

z.Bislim Bilimi: Faleminderit kryesues, përshëndetje për te gjithë! Unë dua ta ngrit një çështje për fshatin Drobesh. Shumë herë e kemi cek, që fshati Drobesh, me numër të banorëve dhe me numër te nxënësve është tejkaluar norma e asaj shkolle që i përfshin ata nxënës. Tash në kohën e fundit është hap edhe një problem tjetër, se është bë numër më i madh i nxënësve parashkollor, me ligje me doket që thuhet mbi 32 nxënësia duhet mu bë një paralele parashkollore. E pyes edhe drejtorin edhe juve, që te na jep përgjigje: Pse nuk bëhet edhe një klasë më tepër me kohë, kur njerëzit kërkojnë punë edhe janë pa punë shumë, e na po e ngushtojmë rrethin, nuk po e mundësojmë hapjen e një vend të punës.

z.Baki Nebiu: Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë! Unë dashta ti paraqes nja tri shqetësime të banorëve të Komunës se Vitisë. Shqetësimi i parë është siguria në fshatin Budrikë, ku në kohën e fundit, në këtë fshat ka ndodhur vjedhje të shumta, ku për katër net radhazi ka thyer shtëpi, kanë vjedhur gjësende me vlerë si dhe kanë kërcënuar banoret e këtij fshati me armë. Dashta të pyes nënkryetarin, pasi që je edhe kryesues i Këshillit në Bashkësi: A e keni

diskutu këtë fenomen në mbledhjen e juaj, si dhe a keni ndërmarr diçka lidhje me këtë provës, që është në vazhdimësi dhe nuk po jeket prej Komunës së Vitisë? Shqetësimi i dytë është, rrethojat në shkollën e fshatit Kabash. Nuk e di si keni menduar, unë jam vetë që e kam kërku rrethojën e fshatit Kabash, pasi që ka pas nevojë, po ju si e keni bërë me at hyrjen kaq të ngushtë, ku as kamjani i mbeturinave nuk mundet me shku të objekti i shkollës me i marr mbeturinat. Pasi që e ka të vështirë të kalon në atë hyrje, dhe e keni bërë at hyrje kaq të ngushtë, unë po du me theksu, se nuk po du me mëndu te e keqja, pasi që një fatkeqësi me ndodh në at shkollë logjikoni se si mundet me hy zjarrfikësit në atë objekt, andaj, kërkoj nga ju, që në shkollat tjera hyrja të jetë me e gjërë, që kamionët me mujtë me hi shpër në ato shkolla. Shqetësimi i tretë është reklamat në qytetin e Komunës së Vitisë, konkretisht këtu në sheshin “Njazi Azemi”. Deshta me pyet drejtorin e Shërbimeve Publike se si ka zhvilluar ky provën e reklamave në qendër të qytetit: A ka pas ndonjë konkurs, apo jo, pasi që bizneset në Komunën e Vitisë nuk kanë qenë të informuar për këtë, dhe janë të interesuar që edhe ata të përfitojnë në këtë promovim të biznesit të tyre.

z.Sejdi Emini: Përshëndetje për te gjithë te pranishmit! Është një seancë që po mbahet pas dy muajve, unë do ta ngris një shqetësim. Te shkolla jonë në Gushicë është një grop septike, e cila është maru para lufte, e kemi ngrit si shqetësim edhe në mbledhjen e fshatit, ku ka qenë prezent edhe drejtori i Financave, mirëpo edhe te drejtori i Arsimit shumë herë e kemi kërku që me u heq ajo, se paraqet rrezik për nxënës edhe për infektim, po edhe është armotizu. Kërkojnë që në te kryhet ajo punë pa u bërë e madhe, se si të bëhet e madhe nuk kemi nevojë ma me ardhë hiq. E dyta, e kamë ngrit një çështje, që mendoj që është jetike për qytetaret e Vitisë, para një tre muajve, çështjen e autostradës. E di që është marr një iniciativë para një dy dite, që me ka pëlqy, edhe pse me vonësë, po me ka pëlqy. Kjo iniciativë megjithatë për do sene të rëndësishme kurrë nuk behet vonë. Po du me ditë edhe një herë unë edhe qytetaret e Komunës së Vitisë, deri ku kanë arrit këto bisedime, nëse është bisedu. Por kjo, pa dallime politike e fetare është një çështje jetike për banoret e Komunës së Vitisë, sepse nëse jemi pa kycje në autostradë, kemi me met zorr qorre po thua që për tërë jetën. Me çfarë të drejte Malisheva e Suhareka kanë nga dy kycje e tri, e sipas qejfeve të tyre personale që i kanë zhvillu, e Vitia mos me pas as një kycje.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Bislim, mua po me vjen mirë që paska numër të nxënësve, aq numër të madhë të nxënësve, se ti e dinë që po ballafaqomi tash me rënie të numrit, duhet ta shqyrtojmë mundësinë pse jo, në raste se në aspekt të ligjeve që janë në fuqi në arsimin parafillor dhe i plotëson kushtet për një vend pune pse jo, jam ithtar i asaj, dhe me të vërtetë ata fëmijë të përgatiten për procesin edukativ arsimor, për fillimin në klasë të paër ashtu qyshe duhet të përgatiten. Çështjen që u ngrite në fshatin Budrikë, kam disa informacione të cilët unë gjithëherë jam shumë institucionalit dhe i dedikohem shërbimit që duhet kryer, d.m.th kam pas takim edhe me komandantin e policisë, i kam marr informacionet e plota lidhur me këtë, megjithatë nuk e di gjendjen bashë qashtu qyshe thave ti katër dite rend, po di që ka ndodhe, e di që kanë qenë në aksion, e di që janë arrestu njerëz, dhe është ka punohet në atë drejtim, ndërsa çështja e sigurisë në Komunën e Vitisë është një prej komunave me siguri më të lartë, ndërsa Këshillin për Siguri

në Bashkësi e kemi nesër, pikërisht për këtë, dhe aty do të bisedohet edhe me gjerësisht, edhe pse kam pas takime me komandantin, të gjitha shqetësimet e qytetarëve i kemi parasysh, te rrethojat në fshatin Kabash e kemi diskutu edhe ne, është e vërtetë, nuk është e standardeve që duhet të jetë, e kanë bërë atë lëshim, unë besoj që me kohë do të bëjmë përmasimin dhe do të përimtohet, se nuk do të lejohet, se edhe mu edhe udhëheqësisë komunale, në krye me kryetarin, është e pa pranueshme një çështje e tillë. Reklamata të cilat u thanë, nuk e kemi drejtorin sot, me lejen time ai merr pjesë në Vushtri, është fjala e një takimi që organizohet nga kryetaret e komunave, e ku unë nuk kam mujt me shku për shkak të Kuvendit, e kur e dimë që kryetarin e kemi në udhëtim zyrtar, dhe e kemi që drejtorin e Shërbimeve Publike. Unë do të ja sjelli këtë pyetje, e di që në baze të konkursit nuk është bërë kjo, është rregullorja ku bëhet kërkesë firma, që është e interesuar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, në aspekt ligjor, po tham drejtoria e shqyrton kërkesën, e në rast që është në përputhje me ato standarde, të cilët janë të parapara në rregullore e merr lejen dhe e vendos. Shqetësimi i Sejdes, drejtori është këtu, ndoshta e din më detalisht, nëse duhet me intervenu edhe unë jam për me intervenu në kuadër të mundësive që i kemi. Të çështja e kyçjes në autostradë, në nuk e kemi pa të udhës, se ndoshta kemi mujt në çdo seancë që e kemi mbajtur për të gjitha takimet që i kemi pas, për këtë me ju njoftu, por na ka dok, ndoshta është monotoni, lodhje e këshilltarëve komunal, me ju tregu që kryetari bisedoj sot me kryeministrin, me ministrin e Infrastrukturës, megjithatë çështja e autostradës nuk është projekt i komunës, këtë duhet me pas të kuart, është projekt nacional, e cila ekzekutohet nga ana e qeverisë. Kërkesat janë shumë të arsyeshme kur shtrohen në aspekt të asaj, por jo tu than që Malisheva i kishte tri kyçje, shumë më vret ajo puna të krahasimi me thanë, unë po du, se ma merr mendja në bazë të banorëve e meritojmë si komunë me pas kyçje. Unë gjithëherë jam pro asaj, por jo me bërë krahasime. Duhet ta shtrojmë si çështje të aspektit ekonomik e aspekte të tjera, se kjo komune meriton me u kyç në autostradë. E di që kryetari ka pas shume takime, e di që janë bërë shumë varianta, dhe me rastin e iniciativës të cilin e kanë organizuar partitë opozitare, së bashku me shoqërinë civile, qashtu ma kanë interpretu mu dhe me grupe të tjera të interesit, që veprojnë në Komunën e Vitisë. Kam bërë përpjekje, jam i përgjegjshëm, d.m.th pa përcaktim të orarit me kanë thirr në telefon, brenda 10 minutave i kam pranë në zyrë, i kemi biseduar dje këto çështje, para se ti pranoj e kam thirr edhe ministrin me marr informacione me detale, dhe ka qenë një pyetje e imja që i bëra ministrit, a je në gjendje ti me ekipin tanë, të cilët e kanë bërë këtë punë, me ardh në Komunën e Vitisë dhe para këshilltarëve të Kuvendit Komunal të Vitisë, para shoqërisë civile që veprojnë në Komunën e Vitisë, me ju shpjegu çështjen e autostradës dhe me i ndëgju edhe kërkesat e tyre. Ai me ka than po, këtë ju kam interpretu atyre përfaqësuesve dje të cilët kanë qenë në zyrën time dhe jam obligu që unë të bisedoj seriozisht. E kame thirr edhe sot në mëngjes e kam bisedu, më tha prite kryetarin, në momentin kur kryetari është aty dhe e caktojme terminin, java që vjen, me siguri do të organizohet një takim i tillë, do të shtrojmë të gjitha ato kërkesa tona në formën më të mirë të mundshme. Tash po e shoh këtu edhe Mirlinda Sadikun, me lejoni ti shpreh ngushëllimet për humbjen e babës, ku kemi shpreh gatishmërinë se

bashku me kryesuesin dhe disa koleg me shku edhe te shpija për ngushëllime, por nuk ka qenë në shpi, atëherë pranoni ngushëllimet me te sinqerta.

Kryesuesi z.Naim Pira: Edhe unë ne emër timin dhe të këshilltarëve komunal ju shprehi ngushëllime.

z.Sejdi Emini: Nuk e di, shumë herë po përmendet kjo marrja në kuvendin tonë. Unë mendoj, që është marre me mete pa kyçje në autostradë, nuk e di unë çka ka me ju than fëmijëve te mi pas 5 ose 10 vite, valla jam kanë këshilltar i kuvendit komunal e kam hesht, jo nënkryetar, nuk është marre, absolut nuk është marre, marre është me hesht, marre është mos me i përfaqësu qytetarët, marre është me vjedh, a marre nuk është mu kanë parimor në të drejtat e qytetarëve, nuk na ka ardh marre me dit me lyp votën e pse me me ardh marre me lype kyçje në autostradë, nuk është marre me than që Malisheva i ka dy, se është fakt. Kisha dashtë që edhe ti me qenë më i kujdesshëm.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Faleminderit kryesuesi, përshëndetje për të pranishmit! Një pyetje mu drejtu mu nga këshilltari Bekim Azizi, lidhje me vendimin e Kuvendit Komunal të Vitisë, lidhur me fondin e vjetor prej 27 mije e 500 euro, që kryeministri nga fondi rezervë ja ka nda Komunës së Vitisë për me i kompenso damet nga vërshimet, dhe atë vendim ne këtu e kemi transmetu para juve dhe e kemi bërë vendimin tjetër, që këto mjete ti kthejmë në kategorinë ekonomike për investime kapitale në mënyrë që dëmin ta parandalojmë përmes investimeve kapitale të renovimit të lumit “Morava”, dhe kemi mendu gjithënjë, se neqoftese ne i kompensojmë demet, ato do të na përsëriten, kështu që, më mirë me qel lumin “Morava”, se me i kompenso demet, se atëherë do të ishte kompensim dhe vërshimet prapë do ta prishin, siç e kanë bërë edhe vitet e kaluara, e ne vendimin e juaj e kemi transmetu në Ministrinë e Financave, e kemi përcjell dhe e kemi kërku që të zbatohet, e ato mjete të na dalin në llogarinë e komunës, në kategorinë ekonomike për investime kapitale. Shuma ka qenë sipas Ligji Mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, që shuma që e tejkalon mbi 25% as kryeministri nuk ka te drejtë me vendos, që ato mjete 100% me i qit me nje kod tjetër ekonomik, kështu që, ai vendim është dashur të kaloj përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës, d.m.th vendimi, po këtë ndryshim që e kemi marr na si Kuvend, është që me marr edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës, nuk e ka marr ate vendim, kuvendi deri me sot nuk e ka marre, por nga presioni i kryetarit të komunës dhe të gjithë neve që kemi bërë presion, që ato mjete me na u kthy, me përmirës gjendjen e lumit “Morava”, para një muj dite e kemi marr konfirmimin edhe zotimin e mjeteve nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë, që naj kanë da Komunës së Vitisë 100 mije euro, për rregullimin e lumit “Morava”, pra, ai presioni jonë që për me i kthy ato 27 mije e 500 ka pas efekt dhe ku shuma është rrit në 100 mije euro.

Kryesuesi z.Naim Pira: I falënderoj te gjithë parafolësit dhe deklaroj që në seancën e IX të rregullt te Kuvendit Komunal të Vitisë kemi paraparë këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e Kuvendit Komunal të Vitisë.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim buxhetit të Komunës së Vitisë për vitin 2017.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim Rregullores për tatimin në pronë të Komunën e Vitisë për vitin 2017.
4. Informatë nga DKA për fillimin e vitit shkollor 2016 – 2017.
5. Propozim vendim për aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2017.
6. Propozim vendim për shkarkimin e Hasan Berishës nga Anëtari i Komitetit për Komunitete.
7. Propozim vendim për emërimin e Anëtarit të Komitetit për Komunitete.
8. Propozim vendime për ridestinimin e mjeteve buxhetore mes projekteve kapitale në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale.

A ka dikush rrethe rendit të ditës ju lutem?, pasi që nuk ka hedhet në votim për miratim i rendit të ditës: Kush është për miratim? Konstatohet që me votat e te gjithëve u miratua ky rend dite.

Pika e parë

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e Kuvendit Komunal të Vitisë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rrethe procesverbalit: A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

z.Bekim Azizi: Procesverbali kësaj radhe e kame pa që është shume jo mirë, faqe 14 dy rreshtat e parë, kur kame fillu me fol nuk e kuptoj çka u desht me kuptu, mirëpo mas fjalimit tim fjalimi i kryetarit ka qenë me fjalë fyese, që kanë qenë atë dit në Kuvend, d.m.th as nja prej tyre nuk kanë hi, e unë kërkoj që të futen në procesverbal, sepse janë përsërit shpesh, ato duhet te futen dhe kërkojë që procesverbali të përimitohet dhe të me vjen i përmirësuar.

Kryesuesi z.Naim Pira: Sekretaria do të korrigjon aty çka u kërkuar, pasi që nuk ka, e qes në votim: Kush është që te miratohet procesverbali i mbledhjes së tetë i Kuvendit Komunal Vitisë me vërejtjet që u dhanë nga Bekimi? Nga te gjithë asamblistët prezent, pika e parë u miratuar.

Pika e dytë

2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim buxhetit të Komunës së Vitisë për vitin 2017.

Kryesuesi z.Naim Pira: Do të ja kalojmë fjalën drejtorit për Financa rrethe kësaj pike të rendit të ditës.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju të nderuar këshilltar komunal dhe ju të pranishëm! Ju të gjithë e keni marr me kohë materialin lidhur, që ka të bëjë me draft buxhetin përfundimtar për vitin 2017 dhe projeksionet për vitin 2018 e 2019. Unë për here kam thënë, që gjatë aktivitetit të Kuvendit komunal dhe Qeverisë komunale, një nder dokumentet me me rendësi që kërkon angazhim, përkrahje dhe transparent të plotë është buxheti që do të miratohet sot ne këtë Kuvend. E unë konsideroj, që edhe aktivitetet lidhur me përgatitjen e këtij buxheti kanë qenë të plota dhe angazhimi ka qenë profesional për me qenë një dokument që i plotëson të gjitha ato kritere që duhet ti plotësoj ne baze te Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Gjate kësaj periudhe të përgatitjes se

buxhetit i kemi pas 25 diskutime publike, me qytetar të lokaliteteve të ndryshme, me struktura të ndryshme të shoqërisë. Kjo ka ndodh me arsye, që ky buxhet, ne shpenzimin e këtij buxheti të jenë te njoftuar maksimalisht, sa është e mundshme qytetarët e komunës, dhe besoj që ja kemi arrit që qytetarët t'i njoftojmë për buxhetin komunal, mënyrën e shpërndarjes ne kategoritë ekonomike etj, ku ne hartimin e këtij buxheti ka pasë pjesëmarrës edhe nga ju asamblist të lokaliteteve të ndryshme, ku ju falënderoj për kontributin e dhënë. Buxheti që është caktuar nga Ministria e Financave për vitin 2017 dhe projeksionet për vitin 2018-2019, nuk kemi qenë të kënaqur me shumën e buxhetit ne vlerën nominale. Buxheti është nda për Komunën e Vitisë, në baze të kriterëve që i ka caktuar komisioni ndërqeveritarë i formuar nga presidenti dhe kryeministri, ku në atë komision pjesë janë edhe disa kryetar të komunave dhe ky komision ka përdor kriteret ligjore, që janë të caktuara me ligje për shpërndarjen e buxhetit komunal. Një ndër kriteret kryesor për shpërndarjen e grandit të përgjithshëm ne komuna është kriteri i numrit të popullsisë dhe kësaj radhe neve me regjistrimin e fundit të popullsisë, ku në Komunën e Vitisë janë diku 47 mijë banor, dhe ne bazë te këtij numri të popullsisë, ata edhe kanë shpërnda grandin e përgjithshëm, prej 3 milion e 600 e 39 mije euro (tre milion e gjashtëqind e tredhjet e nëntëmijë euro). Kriteri i dytë është kriteri i numrit të nxënësve që vijnë në mësimin ne një vit akademik dhe në baze të këtij numri është shpërnda grandit specifik i arsimit prej 4 milion e 100 e 9 mije euro (katër milion e njëqind e nëntë mije euro), dhe kriteri i tretë ka qenë kriteri i vizitave mjekësore, që qytetarët e komunës i bëjnë ne institucione shëndetësore. Në bazë të këtij kriteri, fondi specifik i shëndetësisë është nda ne vlerë prej 1 milion e 100 e 63 mije euro (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë euro). Ne i kemi analizu në drejtorin time, se a janë apliku këto kriterë drejtë dhe kemi ardh në përfundim, se kriteret janë zbatu drejtë. Tash krejt ne bazë të këtyre, shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës se Vitisë për vitin 2017, ka vlerën prej 10 milion e 19 mije euro (dhjetë milion e nëntëdhjetë mijë euro). Pra, kjo është shuma në total që duhet të votojmë ne sot. Kjo shumë plotësohet nga dy burime kryesore, nga grandit qeveritar që financohet me 8 milion e 9 qind e 12 mije euro (tetë milion e nëntëqind e dymbëdhjetë mijë euro), dhe grandit i të hyrave vetanake që kap shumën prej 1 milion e 100 e 6 mijë euro (një milion e njëqind e gjashtë mijë euro). Siç thash në fillim, materialin e keni pranë me kohë, për pyetje jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Falënderon drejtor, unë fillimisht i kisha ftu shefat e grupeve parlamentare që ta marrin fjalën rreth draft buxhetit.

znj. Vjollca Kadolli-Halili: Përshëndetje për nënkryetarin, kryesuesin KFOR-in amerikan dhe ju të pranishëm! Sot para vetes e kemi draft buxhetin 2017-2019, e falënderoj paraprakisht drejtorin për sqarimin të cilat i ka bë. Përgatitja e këtij drafti ne analizën të cilën e kanë bë, shihet që është një buxhet me i kënaqshëm dhe me i favorshëm se sa buxheti i cili po realizohet ne këtë vit, d.m.th ne vitin 2016. Këtë e mbështes ne atë, se buxheti në total në të gjitha kategoritë ekonomike shihet se ka një rritje prej 500 e 31 mijë e 314 euro (pesëqind e tridhjetenjëmijë e treqind e katërdhjet euro), ndërsa vetëm në kategorinë apo kodin buxhetor për investime kapitale, e cila drejtpërdrejtë edhe prek interesat e qytetarëve te Vitisë, kemi një rritje prej 200 e 27 mije e 134 euro (dyqind e njëzeteshtatëmijë e njëqind e tridhjetekatër euro) ose ne përqindje prej 15.02, edhe pse ndoshta kjo nuk është në përputhje me nevojat të cilat ka Komuna e Vitisë. Mirëpo duke pasur parasysh edhe kriteret të cilat i ka shfrytëzu Ministria e Financave, mendojmë se është një ndarje e drejtë, gjithashtu edhe te grandit i shëndetësisë kemi një rritje prej 52 mijë e 793 euro (pesëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre euro), që do te ndikojnë edhe

ne rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Megjithatë duke pasur parasysh edhe të gjitha investimet të cilat janë duke u bërë këto tri vitet e fundit, kërkojmë nga qeveria komunale që në vitin 2017, të ju jepet prioritet sidomos lokaliteteve në të cilat është investuar me pak. Ne si grup i këshilltarëve të LDK-së e përkrahim këtë draft buxhet.

z.Samet Idrizi: Megjithëse krahasuar me vitin e kaluar është një rritje solide, sidomos të investimet kapitale, por nuk është e mjaftueshme. Sa i përket shpërndarjes së buxhetit, unë konsideroj që është në mënyrën më të mirë të mundshme shpërndarja e drejte, ashtu si grup kishim sugjeru tasht, janë sugjerime tona, që mendojmë që me vonë të implementohen. Të mallrat, shërbimet dhe të shpenzimet komunale, është mirë të ulen pak, të rritet riinkasiteti dhe kursimi, në mënyrë që të kemi me shumë vlerë monetare për subvencione dhe shpenzime kapitale, krahasuar me vitin e kaluar, pas vërejtjeve tona që i kemi dhënë si grup është një rritje mirëpo e vogël. Ne e dimë që ndarja e buxhetit bëhet në proporcion me numrin e popullatës, mirëpo unë e kam vërejt që në disa komuna kur e kam krahasuar me popullatën, përafërsisht të njëjta me Vitinë kanë marr me shumë, sidomos për investime kapitale. Tash nuk e di problemi a është të mungesa e projekteve që dorëzohen apo të lobimi prej qendrës lokale atje në qendër, sidoqoftë këto duhet të merren parasysh. Thamë që buxheti është një dokument me rëndësi ashtu siç tha edhe drejtori i Financave, edhe unë si asamblist kam vërejtje të rregullimi i kanalizimeve, të ndahen mjete pak më shumë në raport me asfaltimin e rrugëve rurale. Unë e di që ka nevojë mu të rrugëve rurale, mirëpo unë e kam bërë këtu një bashkëbisedim me qytetarët e Vitisë, shumë lagje këtu në viti nuk kanë kanalizime. Me erdh çudi kur morra vesh, që përball Viva Fresh, atje ajo rrugë bukur është qendrore, nuk ka kanalizim. Është shumë shqetësuese, por edhe në lagjen time aty në fund janë diku 42 shpi, nuk kanë ende kanalizim. Unë fatmirësisht kam, pasi që e kemi bërë vetë me mjete tona vetanake, jemi organizu edhe e kemi bërë kanalizimin. Drejtori edhe nënkryetari të kokan këtu, është mirë që punës së kanalizimi ti japin prioritet në raport me asfaltimin e rrugëve rurale. Po ashtu edhe për ujësjellës nuk ka parë të ndamë të mjaftueshme, mirëpo unë e di që këtu qeveria zvicerane është tu investu në Viti, po edhe këtu ndoshta është mirë të hyra vetanake të ndahen pak me shumë, që me ja nimu edhe qeveris zvicerane, që investon në Komunën e Vitisë. E kam edhe një pyetje, rregullimi i stacionit të autobusëve është parapa të ndahen 20 mijë euro, pyetja është për drejtorin financiar: çka amandamentohet të punohet këtu. Të puna e rregullimit të fushave sportive dhe thurja e oborreve shkollore, unë dëgjova me herët nga asamblisti Bakiu, unë edhe vet i kam pa disa rrethoja po bëhen të dobëta, është mirë mu ba ato me mi resht, mu ba dy të forta se sa tri e të dobëta, se po shkatërrohet shpejtë.

z.Bislim Bislimi: Përshëndetje të nderuar koleg, i nderuari kryetar i Kuvendit të nderuar qeveritar komunal të pranishëm të tjerë këtu në sallon dhe qytetare të Komunës së Vitisë! Me lejoni që të jap qëndrimet, mendimet, lavdatat dhe kritikën e mija dhe të subjektit të cilit i takoj në lidhje me projekt buxhetin për vitet 2017-19. Para se gjithash për shkak të obligimit dhe përgjegjësisë që kemi në kuptim të asaj, se ne si këshilltar duhet ta kryejmë, por edhe në anën tjetër në kuptim të ndihmës sonë apo kontributit tonë, që të ndikojmë në mënyrë që kjo komune të shkojë rrugës së zhvillimit ekonomik dhe social, domethënë rritjes së mirëqenies së qytetarëve, të cilët na kanë obliguar me votat e tyre. Në kuptim të kësaj, të nderuar koleg, kisha pas dëshirë, që kur flasim për këto çështje duhet të jemi unik dhe të mos ndikohemi nga individ apo grup njerëzish, që për interesa të tyre personale nuk kanë këtë interes, por në radhë të parë u intereson karriera dhe vazhdimi i karrierës, se sa këto çështje jetike për komunitetin. Po behen

gati 3 vite qe kemi filluar dhe jemi zotuar se do te punojmë për të përmirësuar dhe rregulluar jetën dhe mirëqenien e qytetareve, se do te punësojmë njerëz, se do të zhvillojmë ekonominë, e shumë e shumë premtime tjera, por ja qe po vie dita qe te japim llogori se sa i kemi arrit, pse kemi ngece etj. Nuk them se nuk është arrit sukses, por vazhdimisht e potencoj, se komuna jonë po të kishte një udhëheqje qe i përkushtohet këtyre çështjeve, do ti kishim tejkaluar vitet dhe dekadat do te shkurtoheshin javët dhe muajt. Tu them te drejtën, nuk e kam menduar se do te duheshin 17 vite qe një fshat po edhe me i largëti i komunës, ta zëmë Debelldehun, Godenin apo Trestenikun e Verbanin, ta gjej një gjendje pa ujë, pa kanalizime, pa ndriçim publik apo pa shërbim te bartjes se mbeturinave, pastaj mungesës se rrugëve rurale dhe bujqësore, mosmirëmbajtjes se tyre dhe shume probleme te tjera, disa prej te cilave mbase edhe do ti diskutoj së bashku me juve. Si fillim kam vërejtje, se materiali qe na është sjell është tepër voluminoz, diku na përsëriten shume herë figurat dhe grafikonet ne forma te ndryshme, por qe ne fakt janë te njëjta. Nuk po e di se a nuk po i kuptoj unë, apo dikush dëshiron te arrihet efekti i lodhjes se atij qe e shfleton, por mendoj se disa gjera duhet te thjeshtohen dhe te përpilohen ne atë mënyre qe te kuptohen lehtë, të jenë të kapshme për çdo individ. Ne shikim të parë buxheti i përpiluar të jep përshtypjen se është i njëjtë me te gjitha buxhetet e mëparshme, vetëm se ndryshojnë shifrat, kuptohet qe vazhdimisht janë ne rritje, vërejtja e parë qe te jepet me kuptua, se shumica e buxhetit shkon për administratë, për burokracinë administrative, e cila është e mbingarkuar për vitin 2014 ka qene 3,8 milion, 2015-3,9, 2016-3,2 qe ka qenë në dekadencë për te fillua me kadencë në vitin 2017-3,6 për v.2018-3,85, kurse për vitin 2019, 4 milion. Ndoshta qytetarët e Vitisë dhe unë kemi te drejte me ba sqarime ne lidhje me këtë. Buxheti i Arsimit nga 4 milion ne vitin 2014, ka një progres, duke u rritur deri ne 5,1 milion në vitin 2019. Shërbimet sociale nga 76 mijë euro ne vitin 2014, rritet në 96 mije euro ne vitin 2019. Duke patur parasysh trendët e stagnimit të zhvillimit ekonomik, jo vetëm ne komunë, po edhe ne nivel qendror, nuk mund te pajtohemi me politikat sociale, sepse varfëria si rezultat i mos përgjegjesisë së politikaneve tanë duhet trajtuar ashtu si e meritojnë qytetarët e varfër, numri i të cilëve me politikat kësisoj vetëm se shtohet nga dita ne ditë, dhe nga viti ne vit. Ne faqen 7 është përshkruar buxheti i Zyrës së Kryetarit, është rreth 100 mijë euro, i Kulturës e Rinise 38 mijë, kurse Bujqësisë dhe Pylltarisë 33 mijë e Shërbimeve sociale 30 mijë. Vazhdimisht e kemi kritikuar dhe kemi theksuar, se zhvillimit ekonomik duhet ti kushtohet shumë më shumë rëndësi. e këtu po ndodhë e kundërta. Si mund ta zhvillosh bujqësinë me 33 mijë euro ne vit, ose si mund tu dalish në ndihme kategorive sociale për çdo ditë ne rritje, me 30 mijë euro ne vit. Kjo arsyetohet vetëm me neglizhencë dhe papërgjegjësi. Të lejosh këto kategori ne vuajtje dhe ne pamundësi te punojnë tokat, dhe te nxjerrin përfitime nga djersa e bujkut është krim. Ne faqe 10 është tabela e shpenzimeve të garantëve buxhetore, ku për shëndetësi granti qeveritar është 937 mijë euro, kurse ai komunal 38 mijë, edhe nga kjo tabelë shihet, se komuna nuk është e interesuar ta përmirësoj kualitetin e shërbimeve mjekësore. Dhe ju përgjegjës dhe ju kryetar, mos u krekosni se po ndërtojmë ambulancë apo po investojmë ne mjekësi, kur ato pare i keni donacione, e ju ia keni bashkëngjitur një shume simbolike. Në faqen 19, paraqitja grafike e subvencioneve dhe transfereve tregon, se administrata komunale, ma mire te themi burokracia komunale, ka gëlltitë 85% te grantëve, shërbimet sociale 15%, arsimit dhe shëndetësia kanë mbetur me xhepa bosh. Në vazhdim, investimet kapitale ne përqindje Administrate gëlltit 90% te tyre, Arsimit 4,5%, Shëndetësia 5,5%, kurse shërbimet sociale shumë të nevojshme mbeten me xhep bosh. Plani për vitin 2018, për këtë vit planifikohen për bujqësi nga qeveria 73 mijë euro, nga komuna 33 mijë

euro, për Shëndetësi dhe Mirëqenie nga qeveria 120 mijë, nga te hyrat vetanake 50 mijë, Shërbime sociale nga qeveria 66 mijë, nga komuna 30 mijë, për Kulturë nga qeveria 100 mijë, nga Komuna 53 mije. Për vitin 2019 për bujqësi qeveria ndanë 72 mijë euro, komuna 33 mijë, për Bujqësi dhe Pylltari nga qeveria 72 mijë nga komuna 33 mijë, në Shëndetësi dhe Mirëqenie, nga qeveria 120 mijë, nga komuna 50 mijë, për Shërbime sociale qeveria 66 mijë, komuna 30 mijë, kultura nga qeveria 100 mijë, nga komuna 53 mijë. Vlen te ceket sa për krahasim, se Zyra e Kryetarit ka për të gëlltit gjate vitit 2017 nga qeveria 309 mijë euro, nga komuna 117 mije euro. Për vitin 2018 kjo zyrë planifikon me gëlltit nga qeveria 305 mijë, kurse nga komuna 120 mijë dhe ne vitin 2019 po kaç mjete buxhetore ne total për 3 vite te funksionimit te kësaj zyre do te gëlltiten rreth 1 milion euro. A ka nevojë tu sqaroj me tepër qytetareve se si shkon paraja e tyre, e cila vilet duke rrit tatimet ne pronë, duke rrit koston e shërbimeve te ndryshme administrative, duke rrit gjobat e shpeshta të përditshme, duke paguar kamata skajshmërisht te larta për ata qe nuk paguajnë me rregull tatimin në pronë etj. Barra e rendë, e cila mezi po bartet mbi kurrizin e qytetareve, skajshmërisht te grabitur e te plaçkitur nga burokratet e këtij shteti dhe te kësaj komune. Tani do te shikojmë me një hedhje syri, projektet investive publike për vitin 2017. Thuhet participimi me donator, ata rreth 200 mijë këta 200 mijë, qe do te thotë rreth fifti-fifti, asfaltimi i rrugës Germovë-goshicë fifti –fifti, rregullimi i rrugëve rurale, qeveria 2, këta pra ne 1 pjesë; Rregullimi i rrugëve me zhavorr, qeveria 2, këta gjegjësisht ne 1 pjesë; Rregullimi i kanalizimeve, qeveria 2, këta gjegjësisht ne 1 pjesë; Rregullimi i ndriçimit, fushave sportive stadiumet, trotuareve, hapësirat publike gjelbërimet, rrethojave, renovimet e shkollave, lumenjtë dhe proçkat etj etj, çdo kund shkon diku fifti fifti, e di kund ma pak, por asnjëherë nuk pash ndonjë projekt te veçantë, madhor që e ka bërë qeveria jone komunale për këto tri vite te kaluara se bashku. E kur dalin ne media, nuk marrin me vehte burokratet qeveritar fifti fifi, as 2 me një, po dalin vet dhe krekosen sikurse ato para i kanë nga prindërit dhe gjyshërit e tyre, e jo nga kurrizi i këtyre shqiptarëve, që me shekuj mbajnë ne këmbë lloj lloj qeveritaresh te papërgjegjshëm. Si përfundim, Vitia ky qytet i pasur me resurse të shumta natyrore, me bukuri natyrore, që rrallë ndonjë qytet mund t’ia kaloj, me resurse ujore si lumej dhe ujera termomineral, a me toka aq pjellore sa rrall ndonjë komune mund t’ia kaloj, me pyje qe dikur i ëndrronte ti këtë çdo komunë, me qytetarë të ndershëm dhe punëtorë, që në kriza me të renda dhe luftëra asnjëherë nuk kane hezitu tu përgjigjen nevojave te kohës, nuk meritojnë të trajtohet kaq brutalisht nga pushtetar, si te nivelit qendror ashtu edhe atyre lokal ,ne mënyre kaç përbuzëse dhe nënçmuese, me humbje dinjiteti dhe krenarie, po mos te them edhe me varfëri te vazhdueshme, kategori kjo qe fatkeqësisht është ne rritje dhe me këto politika as qe do ti behet zgjidhje. Në fund ju ftoj ju të nderuar koleg këshilltar, qe te jeni ne nivel te detyrës, që ju ka caktuar votuesi dhe te mos e votoni këtë projekt buxhet, ta kthejnë ne një ri projektim me përputhje me kërkesat edhe nevojat e kësaj komune.

znj.Mirlinda Sadiku: Përhëndetje për te gjithë! Faleminderit për ngushëllime, për përkrahje, kërkoj falje sot prej qytetarëve të Vitisë, ndoshta nuk muj të jem sot ne nivel të detyrës, megjithatë i kam disa pyetje për drejtorin. Po i referohem faqes numër 30, ku ne kemi faqen 30 dhe faqen 30 a: A do te thotë kjo, që 30-ta është lista definitive e investimeve kapitale që do të behet apo 30 a është, apo 30 a është lista e ngushte? Nëse ki mundësi me na sqaru. Po ashtu me intereson te rivitalizimi i ujësjellësve, ne e dimë që ne këtë Kuvend e kemi miratu një shume prej 100 mije euro për ujësjellësin e Sodovines, Trestenikit nëse nuk gaboje a nuk mendoni që kjo shume është e vogël. Prapë kemi asfaltimin e rrugëve rurale një shume kogjo e madhe, 323 mije

euro. Këtu nuk janë cekur se cilat janë ato rrugë rurale. Në këtë viti vetëm në baze të fotolajmeve kemi arrit me e kuptu, se ku janë ato rrugë që po shtrohen gjithandej në Komunë të Vitisë. Do të thotë, do të ishte mirë që te specifikoheshin kilometrat, shuma sa ka kushtu ato ke mujtë përafërsisht me i shti ne kllapa, d.m.th një sqarim. Te rregullimi i kanalizimeve, mu më është dukur një shume shumë e vogël 50 mijë euro, kur kemi d.m.th një numër kogjo të madh të kanalizimeve, të cilat disa janë jofunksionale, disa ju mungojnë pusetat, disave janë, d.m.th edhe gropat septike nuk janë edhe me standarde të cilat duhet të jenë, kur e dimë që vetëm kanalizimi në fshatin Terpezë ka marr një shumë, nëse nuk gaboj dikund rreth 170 mijë euro, prandaj edhe kjo shumë mu është dukur e vogël. Kemi rregullimin e rrugëve ne zhavorr, prapë nuk është specifiku, më intereson ta di pasi që vetëm 20% të rrugëve të fshatrave Skifteraj. Janë të shtruara me zhavorr, kjo është informatë e konfirmuar nga kryesuesi i fshatit. Më intereson ta di, cilat janë këto rrugë që do të shtrohen me zhavorr, ku do të ju jepet prioritet, ndërtimi i trotuareve, ndriçimi publik, po ashtu unë mendoj që është një shumë e vogël 80 mijë euro. Ka mundësi, ka hapësira ku ka nevojë që të bëhen edhe ndriçime publike edhe trotuaret. Rregullimi i fushave sportive, më behet qefi, megjithatë jam skeptik për këtë shume 40 mijë euro. Nëse shkoni te gjimnazi “Kuvendi i Lezhës”, e shini që investimi që është bërë, nëse nuk gaboj ne këtë, aty vetëm kanë fillu mu dëmtu pajisjet e basketbollit, po ashtu fusha e volejbollit është jo funksionale. Rregullimi i lumenjve dhe prockave, më intereson ta di atë shumën që e ceke me herët, 100 mijë euro: A do ti bashkëngjitet edhe kjo shumë për vitin e ardhshëm? D.m.th që e paska nda qeveria, rregullimi i tregut të kafshëve dhe tregjeve të tjera: A është nënkuptu këtu edhe tregjet, p.sh.: në Pozharan. Është shumë mirë që po rivalizohet stadiumi ne Pozharan dhe në Viti, renovime nëpër shkolla, prapë mendoj që është shumë pak. Ka shkolla që ka nevojë që të intervenohet, 60 mijë euro është një shumë e vogël, si dhe renovimi i ambullantave. Më intereson, e di që ambullanta e fshatin Skifteraj është projekt dy vjeçar: Sa para do të investohen në renovimin e ambulantes në Skifteraj? Po ashtu nuk janë specifiku, cilat ambulanta janë me radhe që te rregullohen.

z.Daut Xhemajli: Përsëritje për të pranishmit, ne po bisedojmë për nja rreth 2 milion euro buxhet, tu e pasë parasysh se shumica absolute e këtij buxheti është për paga dhe mëditje, e ne përkujdesjen kryesore e kemi te shpenzimet komunale, kapitale, për subvencionet ose shërbimet e mallra, që mendoj 20% gati po i bjen përgjithësi me e shfrytëzu komunale. Për me e shpenzu këtë buxhet, unë jam që ministrisë përkatëse, që mos ta kenë mundësin me ardh me shtrur rrugë e me bë kanalizim në Viti, po ata me naj nda buxhetin e na me e menagju e me investu, sepse po shihet që prej qendrës po kryhen do udhë e unë nuk mendoj që ato udhë kanë pas nevojë mu shtru qashtu. Unë mendoj që kane pas nevojë me u bë rrugë taman pernime, edhe sipas projekteve, sipas standardeve, e jo me ju qit edhe një shtresë, mu gërry ajo shtresë që është gati e pa dëmtume ne vende vende. E thashë edhe një herë, unë kam pas vërejtje edhe ne Komitet për te hyrat vetanake, nuk janë të planifikuara mirë, nuk jemi kreativ në planifikimin e këtyre të hyrave. Kemi me një formë kopjim të buxheteve paraprake, edhe unë mendoj, që nuk është ai buxhet kreativ, tu e pas parasysh edhe te disa pozicione, p.sh.: qiraja, shfrytëzimi i hapësirave publike është paushallë, tatimi në pronë nuk është paushallë, por është tatim që me një formë nuk po mujmë me arrit me e realizu kurrqysh, pavarësisht që borxhe kemi shumë. Për parkingun publik, një planifikim që nuk përputhet me atë kontratën, hiq paramasën, nuk e dimë sa ka qenë, por nuk përputhet, u dashtë që te korrigjohet. Të hyrat nga qiraja e shëndetësisë, kjo është me shumë kopi past i buxheteve të viteve të kaluara. Te projektet investime, që për këtë rreth 2 milionëshin, që po dojmë me e orientu, unë mendoj që duhet me ju kushtu kujdes me shumë, sidomos rrugëve bujqësore. Ndoshta në 2017-ën ka me pas rrugë rurale, por në 2018-2019 gati nuk ka me pas rrugë rurale, se me qet trend edhe

rrugët e secilës shtëpi po shtrohet. Unë nuk mendoj që është qasje e drejt. Kjo më shumë kisha propozu, që kjo shume të zvogëlohet dhe të ndahet për rruge, rruge me zhavorr, si rrugët bujqësore sidomos, me menue, që te ndihmohet shkuarja e njerëzve deri te pronat e tyre. Duhet te rritet edhe çështja e renovimit të shkollave, rivitalizimi i ujësjellësve dhe kanalizimeve, tu e pas parasysht se këto ujësjellës e këto kanalizime, unë kam propozu që te behët ndërmarrja komunale për përkujdesjen, se krejt këto investime po ja adresojmë një ndërmarrje, që me një formë nuk e ka adresën ne Viti, edhe larg është përgjegjësia e drejtpërdrejt e tyre karshi mjeteve tona. Rregullim të kanalizimeve, unë mendoj që ndoshta duhet të shtohet edhe kjo puna rregullim i gropave septike, se shumica e kanalizimeve të fshatrave i kemi pa gropa septike.

z.Ali Bajrami: Para nesh e kemi një dokument, që në bazë të këtij buxheti do të funksionojë Komuna e Vitisë. Sikur siç u cek edhe nga drejtori i Financave, në përgatitjen e këtij draft buxheti, ka filluar diku ne muajin Maj. Janë bë shume dëgjime buxhetore, 24, pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë shumë e mirë, me debate është prek esenca e nevojave çka kanë qytetarët e komunës dhe me një punë sistematike, duke filluar prej kryetarit, drejtorëve edhe ne si këshilltar komunal, që kemi qenë nëpër disa debate, është arrit te përpilimi i këtij buxheti për vitin 2017. U cekën shifrat, u cekën numrat, nuk dua të ju lodhi me ato, ajo çka është me rëndësi, e kemi një rritje për investime kapitale, duke marr krahasimin me vitin 2016 me 2017, që është vlera prej 227 mijë euro. A është boll nuk është, por çdo viti një rritje e tillë i mbushë nevojat që janë shumë të mëdhaja. Po në krahasim se ku kemi qenë, sa janë përfunduar, janë në nivel të kënaqshëm. Ajo që vlen të ceket, se këtu te Drejtoria për Rini, Kulturë dhe Sport dhe te e Bujqësisë për subvencione, ato vlera edhe un po them që janë të vogla, por ato naj kanë leju mundësitë buxhetore, nuk ka pas mundësi me shumë që të ndahen. Angazhimi më i madh është bërë për investime kapitale. Për mu çka është me rëndësi është numri rendor 1, participimi i projekteve me donator, kjo vlerë na mundëson se donatorët që paraqiten e që dojnë të investojmë mos ti humbim përshkak të mjeteve që nuk i ka ne dispozicion komuna. Asfaltimi i rrugëve rurale, mirë është qe janë nda, mirë është që po shtrohen, mirë është që po përfundohen, që asnjë qytetari mos ti him në hak, që vitin 2017, ku është ajo e mirë të jetë vit që do te rrumbullakësohen të gjithë, do të heqim prej baltës e të shkelim ne asfalt. Numri rendor 12, është rivitalizimi i stadiumit në Pozheran dhe në Viti. Për mundësit e Vitisë ndoshta është shumë e madhe 100 mijë euro, po sa kanë nevojë ne ato stadione, unë po thamë që është pak, se e dimë çfarë gjendje janë ata djemtë që po e derdhin njersën, në mënyrën më të mirë të mundshme me e prezentu Komunën e Vitisë. Meritojnë një infrastrukturë shumë me të mirë. Renovimi i shkollave, një pjesë dermuese e shkollave është renovu, është punu, e kemi drejtorin këtu, na sqaron me mirë, edhe këtu besoj që do te bëhet një punë shumë e mirë.

z.Bekim Azizi: Buxheti për vitin 2017 10 milion. Nuk po diskutoj pse është 10 milion, se qaq është e parapamë sipas disa faktorëve që i përmendi drejtori. 70% paga dhe mëditje, edhe kjo pjesë nuk do të diskutohet, sepse është numër i caktuar i punëtorëve që duhet të merren pagat. Na d.m.th prej pjesës tjetër 30%, që na mbesin dikun 17%, shkojnë në investime kapitale, dhe 13%, shërbime tjera, mallra dhe shërbime. Mendoj që ka vend të diskutohet buxheti mjaft shumë. Zakonisht na i kemi disa pika kyçe, që i diskutojmë gjatë tërë vitit, zakonisht shërbimet e ndryshme, shërbimet intelektuale, shërbimet kontraktuese të tjera, pajisje, dreka zyrtare, këto d.m.th nuk na vihen këto si kode ose si vlera sa janë të parapamë për vitin 2017, mirëpo i kemi vetëm si vlera të përgjithshme, atje shërbime dhe mallra, mirëpo nuk i kemi si vlera sot, që mundemi t'i diskutojmë dhe tani tan vitin ne mundemi të diskutojmë, pse kjo shumë, pse kjo shumë. Kur ti kemi sot, ne e kishim ditë sa janë të parapamë. Te investimet kapitale është një kopje e tabelës se vitit të kaluar, besoni as renditja nuk ka ndryshuar, vetëm ku u kanë asfaltimi i rrugës Lubishtë tash është asfaltimi i rrugës Germovë-Gushicë. Mirëpo, megjithatë janë tri katër pika që janë të caktuara, se ku bëhet

investimi. Asfaltimi i rrugës Gushicë, shumë mirë e përkrahi, stadiumi Pozharan e Viti, definitivisht mirë, sepse është pjesë që është dashur të investohet, stacioni i autobusve po, por tjerat ku janë. Na e diskutim drejtor, ti disa projekte i ki pas te ndamë, faza e dytë, cila u kanë faza e dytë, se ne nuk kemi planifikuar projekte në dy faza, në dy vite, ti i kishe pas nda ne dy vite. Në Komitetin e diskutuam dy vite, tri projekte, tashti hupen faza e dytë, që u kanë ndërtimi i trotuareve, kanalizimi, fushave, hapësirave gjelbëruese: Tash çka ua bë, pse hupen këto kode? Unë muj mu pajtu që renovimi nëpër shkolla mu kane një kod, sepse na deri në fund të vitit e përcjellim, cila ka dëmtime, cila ka nevojë, mirëpo në do vende tjera, nuk janë të pranueshme asfaltimi i rrugëve rurale. Ani bre me një kod ti bëne tenderimin, por bina një fletë shtesë, tregona cilat janë, definoni cilat rrugë janë. Në këtë formë që jeni tu e pru buxhetin ne këto tri vite, pa i definu asnjë pjesë gati, për mua është e papranueshme, që le hapësirë me diskutu, me dyshu. Në asnjë vend, p.sh.: nuk parashohim mirëmbajtje të varrezave, përcjelli varrezat e vjetra, ku nuk dihet që ka varreza, se janë mbuluar, është mirë të ndahet një kod ose në një periudhë dy tri vite, të behet pastrimi i tyre. Në vitin e kaluar i kemi miratu dy tri rregullore, kemi parapa një rregullore te personat me aftësi të kufizuar, i kemi parapa disa investime të këto, po kerkun nuk janë parapa, nuk është nda asnjë mjet për ta, e kur ta miratojmë një rregullore, se paku ti përmbahemi qasaj, nëse e miratojmë një plan të probabilitetit edhe për qat plan t'i ndajmë disa mjete. Na miratojmë plane, parashohim shumë sene e këtu asgjë nuk shtimi. Planifikim te buxhetit për ujë, asnjëherë nuk është përmend se nuk ka nevojë ndoshta, është puna mirë me ujë, d.m.th që nuk është mirë. Ka pas mundësi të jetë me i kuart buxheti, të jetë me të specifikuar, të e dimë saktësisht ku do te investohet edhe te votohet, përndryshe për mua është i pakjart edhe nuk më bind që me e votu.

z.Baki Nebiu: Faleminderit kryesues! Unë po du mu ndal vetëm te projektet e investimeve, pasi që ato gjitha tjerat u thanë, nuk po du me i përsërit. Me këtë faqe te investimeve publike, sinqerisht nuk po muj me e kuptu, prej 19 projekteve, vetëm 6 prej tyre janë te specifikuar se ku do te investojnë. Pyete cilin dushe asamblist këtu, nuk e dinë se cila rrugë ne Viti, përveç Gushicës ku ka mu shtru, asnjë asamblist i Komunës së Vitisë nuk e di cili kanalizim ka mu rivitalizu, asnjë asamblist nuk e din cilin tretuar, ndriçim ka me u rregullu. Për këtë unë po mendoj, që unë nuk po muje me e kuptu, un jam shumë pro për participimin me projekte me donator, jam shume pro asfaltimit te rrugëve Gushice-Germovë, jam shumë pro projektin të rregullimit të tregut të kafshëve e të tregjeve të tjera, jam shumë pro për rivitalizimin e stadiumi ne Pozheran e Viti, rregullimi i stacionit te autobusëve, renovimi i ambulantave, që është shume pozitive, por nuk jam pro në 13 projekte, që nuk e di ka kanë me shku këto pare. Sinqerisht, secili prej juve e keni pak obligim, se ne përfaqësojmë qytetarin e Komunës se Vitisë, duhet me e ditë ku ka mu shtru rruga, cili projekt ka mu prek, cili fshat është me nevojë se fshati tjetër, këtu nuk ceken as fshatra, këtu vetëm në tërësi. Unë kërkojnë nga ju, që ky draft buxhet të rikthehet dhe të bihet ne formë te specifikuar, se ku ka mu investu këto projekte, se në këtë gjendje nuk po muj me e kuptu. Tjetra pyetje është, se për çka po mendoj është, se ky projekt është pak edhe i mbrapshtë. E them këtë, se duke marr rendësin që kanalizimi shtrohet para secilës pune tjetër, si dhe ujësjellësi, edhe kur e dimë që ne Komunë të Vitisë me shume ka ende nevojë për kanalizim dhe te jepet kaq shume prioritet ndriçimit publik dhe trotuareve, unë nuk po e kuptoj. 100 mije euro është rivitalizimi i kanalizimeve, që nuk dijet a e prek Vitin a jo, po mendoj qytetin, kurse 80 mije euro janë ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimi publik, plus kodin 14 i ndërtimit të trotuareve dhe ndriçimi publik faza e dytë, që bëjnë gjithsej 259 mije euro. Kurse me e krahasu me kanalizim 100 mije euro, unë mendoj që kanalizimi duhet mu kane primar, pastaj të investohet në projekte tjera, siç janë primare edhe trotuari dhe ndriçimi publik. Tjetra është rregullimi i fushave sportive, unë nuk e di sa fusha edhe sa cilësore mujnë mu rregullu me 40 mijë euro. Unë jam shume pro projekteve që japin hapësirë

hapësirave gjelbëruese. Unë e kam një pyetje, se që dy vite fshati Kabash kërkon për mu rregullu një projekt i fushave të parkut, dhe këtu nuk ceket asnjë, edhe unë nuk jam tu mujt me e kuptu pse nuk po i specifikon projektet që i doni me i kalu, kërkush nuk është kundër këtij draft buxheti, por jo në këtë mënyrë.

z.Sejdi Emini: Në krejt qeto investimet kapitale për vitin 2017, ka hapësira me manipulu dhe me i qu herë nga dera jem e herë nga dera jote, e kudo qoftë është viti i fushatës. Unë mendoj që është dashur mu specifiku secili në detalisht, me ditë ku po e qojmë. Te rruga e Gushices e kemi lyp edhe shumë herë në Kuvend. Me të vërtetë ka qenë ma e pa kalueshme gati e pakalueshme. Unë pajtoj plotësisht edhe një metër u shtroftë është qare, mirëpo qeto 40 mijë euro dikun 800 metra i shtron, rruga i ka 2.5 kilometra, te na po i leni punët krejt si gjysë, prapë keni mu kthy në vitin tjetër ose mas dy vite, edhe prapë aty me investitu, megjithatë një pjesë 800 metra është e dermume total edhe ka qenë nevojë emergjente, edhe unë besoj që është në interesin e qytetarëve, mirëpo me e pas kry komplet kishte qenë shume me mirë.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Unë në radhë të parë dua ta falënderoj drejtorin me krejt shërbimin që ka bërë përpjekje, që sot para juve të sjell një dokument që është i rëndësishëm së veçantë. Ju falënderoj edhe juve për përkushtimin, për vërejtjet, propozimet që janë dhënë në këtë. Megjithatë e tha drejtori edhe në fillim, se përpjekje për me e bërë një draft buxhet, një dokument në përputhjen me mendimet e qytetarëve. Ky përkushtim nuk ka munguar, ka ekzistuar në vazhdimësi, ku i kemi pas 25 dëgjime buxhetore, ku në mesin e tyre e kemi një databazë shume të mirë nga ana e kryetareve të këshillave të fshatrave. Ndoshta në këtë rast po du me lidh ata të cilën nuk është e specifikuar, ata të cilën po e kërkoni ju me emërtim të rrugëve rurale, por megjithatë po ju zotohem këtu para jush, se nuk do të jetë asnjë rrugë, as asfalt as rërë e shtrume, në rast që nuk është e propozuar nga ana e këshillit të fshatit. Kjo nuk ka ndodh edhe nuk do të ndodh. Në i kemi kriju të gjitha këshillat e fshatrave, edhe unë besoj se janë në koordinim edhe me këshilltarët e Kuvendit Komunal, të cilët i keni ju përfaqësues këtu, dhe krejt këto mue më pëlqej. Edhe një propozim, nuk e di i cilit këshilltar ke, kur i propozon qeveris dhe kabineti të kryetarit ato lokalitete të cilët brenda këto tri vite është investu me pak, të shiqohet dhe të investohet me shumë, që unë pajtoj plotësisht, pajtoj plotësisht edhe ata të cilën e tha këshilltari i fundit, që rruga e Gushices dhe e Trestenikut duhet të përfundojë, se janë në gjendje me të vështira. Nuk e kemi shti Trestenikun, se jemi në bisedë e sipër, ndoshta mos po kalon përmes atij projekti nga Komogllava deri në Sllatinë, se për ndryshe do të ishte edhe ajo pa dyshime. Nuk jemi leshu në aspektin e fushatës, por megjithatë pse nuk jemi leshu po e them, se modeli i qeverisjes së kryetarit ka qenë i tillë edhe për tri vite të cilët po e lëmë pas. Është e vërtetë, se me peshore të arit me i mate ku ka me shumë e ku me pak nuk kemi mundësi, unë po e them me keqardhje, që unë nuk kam pas ku me shtru në Remnik rrugë, se krejt kanë qenë të shtrume, prandaj duhet të shtrojmë në ato lokalitete të cilët nuk kanë qenë dhe po e bëjmë atë dhe gradualisht po vimë tu i pa nevojat aty ku ka nevojë, prandaj, unë besoj që nuk kemi nevojë me e zgjatë. Kisha kërkun nga të gjithë këshilltarët, draft buxheti nuk është, nuk do të jetë i pozitës e as i opozitës, do të jetë i qytetarëve të Komunës së Vitisë. Prandaj, unë e kam thënë shumë herë, për mu nuk ka qenë i kënaqshëm, pse nuk ka qenë, se në kemi nevojë shumë më shumë seç e kemi këtë buxhet, megjithatë duhet të pajtohemi me kriteret të cilët i kanë caktuar. Unë ju kisha ftu të gjithëve, që të jemi unik dhe të votojmë pro kësaj, besoj që është një dokument, në ato mundësitë që i kemi pas edhe profesionale, por edhe mundësitë që i kemi bërë me qytetarët, janë bërë përpjekje maksimale t'i prekim të gjitha ato nevoja në kuadër të cilave i kanë paraqit edhe vete qytetarët, por edhe këshillat e fshatrave. Ju faleminderit për kontributin që dhatë, por edhe për vërejtjet e dhëna.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Nuk do te ju marr kohë shumë, por vetëm ne ato pikat për sqarim. Maksimalisht jemi mundu me qenë i përgjegjshëm buxheti, në kuptimin e anës profesionale. A do të arrim qëllimin me i plotësu të gjitha këto vërejtje që i dhat ju, unë i dëgjova shume me vëmendje, po në shumë aspekte fuqia e buxhetit ndikon që mos me i përfshi të gjitha ato që ju sot i propozuat, edhe që janë plotë të arsyeshme. Kërkesat që janë paraqitur nga dëgjimet publike dhe kërkesat që janë ardhur nga administratorët e fshatrave, kërkesat kryesore janë përfshirë ne këtë buxhet. Ishte një pyetje për faqen 30 dhe 30a, ato janë dy lista të investimeve kapitale, por njëra shkon në ministri të financave, komuna jonë renditet një nder komunat që fondi i pagave, numri i te punësuarve merr një përqindje shume të madhe ne Komunën e Vitisë, fondi i pagave është 70%. Unë e kam llogaritë, vetëm të ishe numri i punëtorëve, d.m.th vetëm për 5% me pak, për 5% fondi për investime kapitale do te ishte rritur diku për 600 mijë euro. Por, ne e kemi trashëgu një fond të të punësuarve. Një nder komunat që ka me shumë të punësuar është Kamenica, por edhe komuna jonë bënë pjesë ne komunat që kanë numër te madh të të punësuarve, gjë që kjo është ajo që ndryshon, që një komunë me e vogël ka buxhet për investime kapitale më shumë apo një komunë që ka buxhet me pak ne investime kapitale ose e kundërta. Kjo është defekti ne këtë kuptim. Të hyrat vetanake, unë përherë jam pajtu me ata që kanë vërejtje në këtë drejtim, i vetmi sovranitet i plotë i komunës edhe i kryetarit me qeverinë është në të hyrat vetanake. Këto duhet gjithmonë me pas intencë me i rritë, duhet me i gjetur metodat, dhe në këtë kuptim nuk ka asgjë të keqe. Kushdo që propozon ndonjë rrugë tjetër, apo ndonjë mundësi tjetër, janë dyert e hapura, se ky buxhet që plotësohet nga të hyrat vetanake e ka kuptimin ma të plotë të mundshëm. Shpërndarja e të hyrave vetanake nëpër drejtori nuk e kemi bërë më hamendje. Në Drejtorinë për Financa, të gjithë drejtorat e drejtorive, saktësisht e dinë në cilët sektor kanë me i grumbullu saktë e dinë, analiza e tyre është ma e përafërmja dhe ata kanë besuar, se në këtë mënyrë secila drejtori duhet të mbledhë kaq të hyra vetanake, sikurse edhe unë në drejtorin të cilën e udhëheqë .

Kryesuesi z. Naim Pira: Unë ju falënderoj të gjithëve që dhatë kontribut për draft buxhetin për vitin 2017-2019, dhe natyrisht prezent janë 26 këshilltar komunal. Unë e hedhi në votim për miratim. Me 23 vota pro dhe 3 kundër miratohet buxheti. Unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, besoj që e kemi merituar një pushim dhe do të kthehemi me vazhdim të seancës në ora 13:00.

Vazhdojmë me punimet e seancës.

Si pikë tjetër të rendit të ditës kemi :

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim Rregullores për tatimin në pronë të paluajtshme në Komunën e Vitisë, për vitin 2017

Lus drejtorin që ta merr fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Te nderuar anëtar të Kuvendit Komunal të Vitisë! Ligji na obligon që krahas miratimit të buxhetit për vitin vijues, të ndryshohet apo të miratohet rregullorja e re mbi tatimin mbi pronën e paluajtshme. Me kohë e keni pranuar materialin, për pyetje dhe përgjigje jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z. Naim Pira: Faleminderit drejtor! Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm? Nëse nuk ka, e hedhi në votim që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Konstatoj se me vota unanime u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Si pike të katërt e rendit të ditës kemi:

4. Informatë nga DKA për fillimin e vitit shkollor 2016 – 2017

Por meqenëse drejtori i Arsimit është pak i nxënë me televizionin, KTV-ja ka ardhur me rastin e dy kuzhinave që janë hapur në shkolla, unë kisha propozuar që këta ta lëmë si pikë të fundit të rendit të ditës, në mënyrë që të kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Atëherë si pikë të pestë kemi:

5. Propozim vendim për aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit Komunal të Vitit të Vitisë për vitin 2017.

Ne për çdo vit, natyrisht edhe sivjet kemi paraparë që para juve të sjellim një plan të punës të Kuvendit Komunal për vitin e ardhshëm, të cilat do të mbahen, në këtë rast dëshiroj ta falënderoj DEMOS-in për angazhimin dhe përkrahjen, e cila na i ka dhënë rreth përpilimit të këtij plani të punës, dhe unë si të tillë e kam sjell sot para jush. Atëherë fjala është për ju nëse donë me marr fjalën dikush ju lutëm. Nëse nuk ka, atëherë e hedhi në votim që të shkoj për miratim: Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Konstatohet se me vota unanime u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim vendim për shkarkimin e z. Hasan Berishës nga Anëtari i Komitetit për Komunitete.

z.Hasan Berisha na ka sjellë një letër, ku ka afruar dorëheqjen nga kjo pozitë, përkatësisht nga anëtari i Komitetit për Komunitete, për faktin që nuk po mund me ushtrua veprimtarin e tij. Meqë kuvendi e ka zgjedh, jemi të obliguar edhe ta shkarkojmë: Kush është që ta lirojmë nga kjo pozitë? Konstatohet se me vota unanime u miratua edhe ky propozim vendim.

Si pikë tjetër kemi:

7. Propozim vendim për emërimin e Anëtarit të Komitetit për Komunitete.

Bëhet fjalë për z. Rifat Haniqin, është i komunitetit hashkali, vjen nga Pozherani, dhe pasi jemi të obliguar që ta zëvendësojmë me anëtar të ri dhe besoj që do ta merr përkrahjen e juaj: A ka dikush me diskutuar diçka? Pasi nuk ka për të diskutuar, po e hedh në votim këtë pikë. Konstatohet se me vota unanime miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë tjetër kemi:

8. Propozim vendime për ridestinimin e mjeteve buxhetore mes projekteve kapitale në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale.

Ftoj drejtorin e drejtorisë, që në pika të shkurtra që ta paraqes këtë propozim.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Ja që në Drejtorinë për Financa ka shumë tema që duan me punu me ju, edhe kështu që edhe kur të ju lodhi kam arsye. Në bashkëbisedim me kryesuesin e kemi menduar që me urgjencë me shti këtë pikë të rendit të ditës, meqenëse me kohë nuk e kemi konsultuar KPF-në, kemi menduar gjithmonë, që në qofëse këtë pikë të rendit të ditës, këtë propozim vendim në kategorinë ekonomike për investime kapitale ta kishim lënë edhe muajin e ardhshëm, do të vonohemi në kuptimin e procedurave ligjore të bartjes së këtyre mjeteve. Materialin e kemi marrë me kohë, për pyetje apo ndonjë sqarim, jam në dispozicion tu ndihmoj.

Kryesuesi z. Naim Pira: Faleminderit drejtor, hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm? Po më duket se nuk ka, atëherë e qesim në votim për miratim: Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Konstatohet se me vota unanime u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Na si pikë të fundit e lamë **Informatë nga DKA për fillimin e vitit shkollor 2016 – 2017**, po tash nuk kamë informatë drejtori ku është, atëherë po ju pyes: A jeni që kjo pikë të mbetet për seancën e radhës? Me ngritje dore ju lutëm. Konstatoj se jemi të gjithë të pajtimit, dhe një pikë tjetër që e ka propozuar z.Andan Imeri sigurisht që do të vi në seancën e ardhshme

Kryesuesi z.Naim Pira: I falënderojë të gjithë për kontributin e dhënë në këtë seancë dhe ju dëshirojmë pushim të këndshëm. Mirupafshim në seancën e ardhshme.

Mirupafshim!

Mbledhja përfundoi me punë në ora 13 e 30 min.

Procesmbajtës:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal-Viti
z.Naim Pira
